

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 36, datë 30.12.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 9, DATË 26.2.2008, “PËR TATIMIN E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PASURISË SË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 9, datë 26.2.2008 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, të ndryshuar, në pikën 10, fjalë e katërt dhe e pestë, ndryshohen me përmbajtjen e mëposhtme:

“Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme paraqesin për çdo muaj formularin e deklarimit dhe të pagesës së tatimit në burim, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të muajit për të cilin bëhet deklarimi dhe paguajnë tatimin e deklaruar për atë periudhë tatimore (muaj), në ose para datës së detyrueshme të deklarimit”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCEVE

Shkëlqim Cani

MINISTRI I DREJTËSISË

Nasip Naço